REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. / Org Jedinica / Org Unit: 5
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 3419
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages
Data: / Datum: / Date: 24.12.2024

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*
*Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Datë: 24.12.2024
Nr. 5/3419

Komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL në Ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë dhe Udhëzimit Administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat te Arsimit të Lartë ne Kosove, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Mbetet në fuqi vendimi me nr. 5/3235 e dt. 22.11.2024 i Bartësit Privat të Arsimit të Lartë / Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji" UBT " SH.P.K. kampusi kryesore në Prishtinë i cili licencohet për periudhën 2 vjeçare 2025-2027 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2027).

2. Refuzohet si i pa bazuar vendimi me nr. 2/1K-3419 i dt. 13.12.2024 i komisionit për ankesa të nëpunësve Publik dhe Ankesave të tjera në MASHTI.

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**A r s y e t i m**

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve Private të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të vendimit nr. 2/1K-3419 i dt. 13.12.2024 të komisionit për ankesa të nëpunësve Publik dhe Ankesave të tjera në MASHTI dhe procesverbalit të takimit të mbajtur me datë 17.12.2024, Komisioni për licencim dhe ri licencim të BPrAL/ Kolegjeve Private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licence që zgjat dy vite akademike për programin e studimit "Inxhineri e Energjisë dhe Mjedisit MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik"

BPrAL / Kolegji " UBT" kampusi kryesore në Prishtinë kërkesën nr. 3239 e ka dorëzuar në MASHTI me datë 04.11.2024 jashtë afati ligjor pranë komisionit për licencim dhe rilicencim të IPAL, edhe pse Agjencia e Kosovës për Akreditim ka lëshuar vendimin me nr. 2270/24 i dt. 06.11.2024 për akreditimin e programit të shënuar më lartë i cili nuk korrespodon me fillimin e vitit të ri akademik 2024/25 bazuar në ligjin e Arsimit të lartë si dhe aktet tjera nënligjore.
Prandaj, komisioni nuk gjeti bazë ligjore që mund ta arsyetonte vonesën e nxjerrjës së vendimit nga AKA-ja për akreditimin e programit "**Inxhineri e Energjisë dhe Mjedisit MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik**" ashtu që ta lëshonte licencën në proporcion me kërkesën e parashtruar.
Duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin e kompletuar për aplikim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Vendimi është përfundimtar në procedurë administrative, ndërsa ankuesi mund të iniciojë konflikt administrativ konform legjislacionit në fuqi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Komisionit për ankesa në MASHTI;
2. Kolegjit "UBT";
3. Komisionit për licencim BPrAL;
4. Sekretarit të Përgjithshëm;
5. DALSHT;
6. Inspektoratit të Arsimit;
7. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

**Burim Gashi**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit: 5
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 3235
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages: 2
Data: / Datum: / Date: 22/11/2024

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*
*Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Datë: 22-11-2024
Nr. 5/3235

Komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL në Ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë dhe Udhëzimit Administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat te Arsimit të Lartë ne Kosove, shqyrtoi kërkesën nr. 3239 të datës 04.11.2024 të parashtruar nga BPrAL- "Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji" UBT SH.P.K., dhe mori këtë:

**V E N D I M**

1. Bartësi Privat i Arsimit të Lartë / Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji" UBT " SH.P.K. kampusi kryesor në Prishtinë, licencohet për periudhën 2 vjeçare 2025-2027 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2027), për programin e studimit:

   1.1. **Inxhineri e Energjisë dhe Mjedisit MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik.**

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**A r s y e t i m**

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve Private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 3239 të datës 04.11.2024 të parashtruar nga BPrAL/Kolegji" UBT " vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.
Licenca zgjat dy vite akademike për programin e studimit sipas paragrafit 1. respektivisht pikës 1.1 të dispozitivit.

BPrAL / Kolegji " UBT" kampusi kryesor në Prishtinë kërkesën nr. 3239 e ka dorëzuar në MASHTI me datë 04.11.2024 jashtë afati ligjor pranë komisionit për licencim dhe rilicencim te IPAL, edhe pse Agjencia e Kosovës për Akreditim ka leshura vendimin me nr. 2270/24 i dt. 06.11.2024 për akreditimin e programit të shënuar më lartë i cili nuk korrespodon me fillimin e vitit të ri akademik 2024/25 bazuar në ligjin e Arsimit të lartë si dhe aktet tjera nënligjore.
Prandaj komisioni nuk gjeti bazë ligjore që mund ta arsyetonte vonesën e nxjerrjës së vendimit nga AKA-ja për akreditimin e programit **"Inxhineri e Energjisë dhe Mjedisit MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik"** ashtu që ta lëshonte licencën në proporcion me kërkesën e parashtruar.
Duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin e kompletuar për aplikim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

**Vendimi u dërgohet:**
1. Kolegjit "UBT";
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të Përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

**Burim Gashi**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE AND TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit: 21 |k
Nr.Prot. / Broj Prot. / Prot.No: 3419
Nr.i faqeve / Br.strânica / No.pages
Data / Datum / Date: 13.12.24

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada – Government***

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja i Nauke,Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

**Komisioni për Ankesa të Nëpunësve Publik dhe Ankesave tjera në MASHTI**

**Nr.** 21/k-3419
**Datë:** 13. 12.**2024**

Në bazë të nenit 37, 53 paragrafi 2, neni 83, 124, 125. 127,128 129, të Ligjit Nr.05/L-031 Për Proceduren e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.20/21 qershor 2016, Prishtinë), Komisioni për Ankesa të Nëpunësve Publik dhe Ankesave tjera në MASHTI, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Kthehet në rishqyrtim në Komisionin për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë – BPrAL në MASHTI, ankesa me nr. prot: 3419 e datës 27.11.2024 e Kolegjit Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" SH.P.K.

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij

**A r s y e t i m**

Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" SH.P.K. ka parashtruar ankesë me dt: 27.11.2024 me nr. prot: 3419 pranë Komisionit për Ankesa të Nëpunësve Publik dhe Ankesave tjera në MASHTI, kundër vendimit nr. 5/3239 të dt. 22.11.2024 të lëshuar nga Komisioni për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë – BPrAL në MASHTI.

Komisioni për Ankesa të Nëpunësve Publik dhe Ankesave tjera në MASHTI pas shqyrtimit të lëndës dhe pretendimeve të palës, konstatoi se bazuar në UA nr. 25/2012 Licencimi i Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, konkretisht Neni 5 Kërkesa për licencë ku thuhet se: *Çdo BPrAL, pasi të jetë akredituar nga AKA mund të licencohet nga MASHT*, dhe Neni 6 Licencimi,

paragrafi 1 ku thuhet se: *MASHT licencon BPrAL të cilët ofrojnë programet e akredituara nga agjencitë e njohura akredituese, anëtare të organizmave ndërkombëtare të akreditimit, pasi programi i tyre aprovohet nga AKA.* Në paragrafin e 2-të thuhet: *Afati i licencës mund të zgjasë varësisht nga kohëzgjatja e akreditimit nga AKA, por jo më gjatë se 5 vite.* Ndërsa në paragrafin e 3-të thuhet se: *BPrAL duhet të kërkojë plotësim licence në raste të akreditimit të programeve të reja apo hapjes së një njësie akademike në qendër tjetër*, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla juridike:** Vendimi është përfundimtar në procedurë administrative, ndërsa ankuesi mund të iniciojë konflikt administrativ konform legjislacionit në fuqi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Kolegjit Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" SH.P.K;
2. Komisionit për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në MASHTI;
3. Komisionit për Ankesa të nënpunësve Publik dhe Ankesave tjera në MASHTI;
4. Zyres së SP/MASHTI;
5. Arkivit të MASHTI-t.

Ilza Sylejmani

Kryetare e komisionit

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo obrazovanja, nauke,tehnologije i inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

# PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komisionit per licencimin e BPrAL e mbajtur me 12.11.2024 në ora 14.45
Kati i III, zyra 313, MASHTI

Komisioni per licencimin e BPrAL: Burim Gashi, Habib Aliu, Bekim Samadraxha.

Munguan: Besim Muharremi, Elhame Shabani.

Mbledhja filloi ne ora 14.45 dhe u kryesua nga kryesuesi i komisionit z. Burim Gashi.

Në këtë mbledhje u shqyrtua kërkesa për licencimin e programit " Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis MSc, Kampusi Kryesor Prishtinë".

Kryetari i komisionit, z. Burim Gashi, e filloi takimin duke njoftuar komisionin për kërkesën e drejtuar nga UBT për licencimin e programit të lartëpërmendur, program i cili në bazë të nenit 6 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 25/2021 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, për herë të parë nuk është akredituar, mirëpo pas ankesesë së bërë siç thekson dhe Arianit M. Krasniqi se, te premten me 1 nëntor në mbledhjen 130 të KSHC-së është shqyrtuar rekomandimi i komisionit të ankesave për korigjimin e vendimit 1711/24 të datës 20.08.2020. Me këtë rast, KSHC ka miratuar rekomandimin e komisionit të ankesave dhe pas shqyrtimit të lëndës ka vendosur të akreditohet programi i studimit Inxhinieri e Energjise dhe Mjedisit, Msc për periudhë 3 vjeçare. Kuota e studenteve për regjistrim është 80 student për vit akademik.
Kryetari i komisionit, z. Burim Gashi, theksoi se, edhe pse programi ishte në proces të akreditimit dhe pa një vendim përfundimtarë, Kolegji UBT-së ka regjistruar student në këtë program te studimit, gjë që është në kundërshtim me vendimin e AKA-s dhe Ligjin. Andaj, propozoi që: Programi i studimeve " Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis MSc, Kampusi Kryesor Prishtinë", të licensohet për vitin 2025-2026.
Sipas z . Habib Aliu janë dy çështje problemore: njëra ka të bëjë me vonesat që ndodhin për marrjen e lejes, si dhe regjistrimi i studentëve nga Kolegji në fjalë. Ai shtoi se edhe pse kanë qenë në dijeni që programi i tyre nuk është akredituar ende, por është në proces, ata kanë regjistruar studentë. Andaj dakordohem me kryetarin dhe kërkoj që ky vendim tu dërgohet edhe dy antarëve të tjerë.
Z. Bekim Samadraxha gjithashtu theksoi se këto çështje do të duhej të trajtohen me më shumë seriozitet dhe përgjegjësi, si dhe programi "Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis MSc, Kampusi Kryesor Prishtinë" të licencohet, por jo për këtë vit.

Komisioni, i përbërë  nga kryetari z. Burim Gashi dhe dy anëtarët z. Habib Aliu dhe z. Bekim Samadraxha në formë unanime mori vendim që programi "Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis MSc, Kampusi Kryesor Prishtinë" të licencohet për vitin akademik 2025-2026.

Takimi përfundoi në ora 15.00

**Komisioni per licencimin e BPrAL**

- Burim Gashi, kryesues ____________________
- Bekim Samadraxha, anëtar ____________________
- Habib Aliu, anëtar ____________________
- Elhame Shabani, anëtar ____________________
- Besim Muharremi, anëtar ____________________

*Prishtinë,  12 nëntor 2024*

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo obrazovanja, nauke,tehnologije i inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

# P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e Komisionit për licencimin e BPrAL e mbajtur me 17.12.2024 në ora 10.00
Kati i III, zyra 313, MASHTI

Komisioni për licencimin e BPrAL: Burim Gashi, Habib Aliu, Bekim Samadraxha, Elhame Shabani.

Mungoi: Besim Muharremi

Mbledhja filloi në ora 10.00 dhe u kryesua nga kryesuesi i komisionit z. Burim Gashi.

Në këtë mbledhje u rishqyrtua vendimi për licencimin e programit " Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis MSc, Kampusi Kryesor Prishtinë".

Kryetari i komisionit, z. Burim Gashi, e filloi takimin duke njoftuar anëtarët e komisionit për vendimin e marrë nga Komisioni për Ankesa të Nëpunësve Publik dhe Ankesave të tjera në MASHTI, që të kthehet në rishqyrtim vendimi i marrë nga Komisioni për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë - BPrAL në MASHTI, për ankesën me nr. prot: 3419 e datës 27.11.2024 të Kolegjit Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT" SH.P.K.

Z. Burim Gashi: Ne, si komision, në formë unanime kemi marrë vendim që licenca për programin "Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis MSc, Kampusi Kryesor Prishtinë" t'i jepet për vitin akademik 2025/2026. Si rrjedhojë, nga ankesa e parashtruar nga Kolegji UBT, Komisioni për Ankesa të Nëpunësve Publik dhe Ankesave të tjera në MASHTI kërkoi që ta rishqyrtojmë këtë vendim.

Znj. Elhame Shabani, ne kemi marrë një vendim që është bazuar në legjislacion dhe kërkesën e parashtruar, prandaj unë propozoj që t'i qëndrojmë mbrapa vendimit që kemi marrë.

Z. Bekim Samadraxha, nuk e di pse kthehet vendimi në rishqyrtim, kur nuk ka asnjë dokument shtesë apo ndonjë argument tjetër që do ta ndryshonte vendimin. Po ashtu, ne kemi dhënë vendimin më të mirë të mundshëm në kuadër të rrethanave. Ne kemi lëshuar licencën për vitin

2025/2026. Komisioni i ankesave është dashur që, përpara se të dërgojë në rishqyrtim këtë vendim, të kërkojë dokumente dhe arsye nga ne, e jo të kthejë në rishqyrtim vendimin.

Z. Habib Aliu, mendoj se komisioni do të duhej të ishte më i përgjegjshëm dhe më serioz në trajtimin e dokumentacionit dhe, po ashtu, më mirëkuptues për të nxjerrë një vendim pozitiv.

Sipas z. Bekim Samadraxha dhe z. Burim Gashi, kolegji ka probleme me Agjencinë për Akreditim për vonesë të vendimit, edhe pse ata kanë aplikuar me kohë dhe jo me ne si MASHTI, sepse agjencia ka lëshuar vendim retroaktiv duke akredituar programin në muajin nëntor për të filluar nga muaji tetor. Po ashtu, në ankesën e parashtruar nga Kolegji UBT, thuhet se viti akademik për studentët e nivelit Master fillon nga 1 dhjetori sipas statutit të kolegjit, gjë që është e papranueshme, sepse në vendin tonë nuk mund të fillojë viti akademik në dhjetor për arsye se nuk mund t'i regjistrojë studentët në SMIAL.

Z. Habib Aliu, unë propozoj që të rishikohet ky vendim bazuar në nenin 6, pika 3 të Udhëzimit Administrativ dhe bazuar në licencën e fundit që ka ky institucion.

Z. Burim Gashi, znj. Elhame Shabani dhe z. Bekim Samadraxha vendosën që vendimi të mos ndryshojë, pasi që kolegji në fjalë nuk ka sjellë asnjë argument apo dokument për të vërtetuar të kundërtën. Si dhe Komisioni për Ankesa të Nëpunësve Publik dhe Ankesave të tjera në MASHTI nuk është konsultuar aspak me Komisionin për Licencimin e BPrAL, gjë që i bën jo profesional.

Në fund të mbledhjes, me tri vota për dhe një kundër, Komisioni për Licencimin e BPrAL vendosi që në fuqi të mbetet vendimi i kaluar, që licencimi për programin "Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis MSc, Kampusi Kryesor Prishtinë" të bëhet për vitin akademik 2025/2026.

Mbledhja përfundoi në ora 11.00

Komisioni per licencimin e BPrAL

- Burim Gashi, kryesues
- Bekim Samadraxha, anëtar
- Habib Aliu, anëtar
- Elhame Shabani, anëtar
- Bekim Samadraxha, anëtar

*Prishtinë, 17 dhjetor 2024*

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo obrazovanja, nauke,tehnologije i inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

# P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e Komisionit per licencimin e BPrAL e mbajtur me 18.11.2024 në ora 10.00
Kati i III, zyra 313, MASHTI

Komisioni per licencimin e BPrAL: Burim Gashi, Habib Aliu, Bekim Samadraxha, Besim Muharremi, Elhame Shabani.

Mbledhja filloi në ora 10.00 dhe u kryesua nga kryesuesi i komisionit z. Burim Gashi.

Në këtë mbledhje u rishqyrtua kërkesa për licencimin e programit " Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis MSc, Kampusi Kryesor Prishtinë".

Kryetari i komisionit, z. Burim Gashi, e filloi takimin duke njoftuar komisionin për kërkesen e lartëpërmendur dhe vendimin e marrur në takimin e kaluar, në mungesë të dy anëtarve të tjerë, sot paraqesim prap të njejtën kërkesë për rishqyrtim që në mënyrë unanime të marrim një vendim të përbashkët në konfort me vendimet dhe ligjet, në takimin e kaluar ne kemi marrur vendim që, licencimi i programit "Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis MSc, Kampusi Kryesor Prishtinë", të bëhet për vitin akademik 2025/2026, dhe jo tani, sepse akreditimin e ka marrur në daten 04.11.2024, ndërsa viti akademik fillon me 01.10.2024.
Sipas znj.Elhame Shabani nuk ka korrespodim dhe nuk perputhet aspakt që viti akademik të filloj me 01.10.2024 dhe të akreditohet me 04.11.2024, dhe nëse ne pranojmë që licencimi të bëhet tani në këtë kohë atëherë bëjmë shkelje, andaj unë i qëndroj prapa vendimit që keni marrur në takimin e kaluar që licencimi i programit të lartëpërmendur të bëhet për vitin 2025/2026.
Z. Habib Aliu, faji është i agjensionit, sepse agjensioni duhet t'i tregoj institucionit nëse e ke akreditimin apo jo, ose nëse bëhet akreditimi, të bëhet për vitin tjeter dhe jo tani në një kohë jo të duhur, po ashtu unë dua të parashtroj një kërkesë, a ka mundësi që ne si institucion të gjejmë ndonjë lehtësim tjetër për këtë çështje përpos këtyre bazike.
Z. Besim Muharremi, nuk jam për kurrëfar lehtësimi, nuk shtoj asnjë fjalë nga vendimi i marrur në mbledhjen e kaluar, sepse tani është gjysma e nëntorit dhe do të ishte e pakuptimt të licensohej programi ose te krijohen lehtësime.
Z. Habib Aliu, po ashtu kam dhe një propozim tjetër, që kryesuesi z. Burim Gashi të caktoj një takim me ministren znj. Arbërie Nagavci dhe të diskutoj çështjen e AKA-së sepse ne po mbesim "fajtorët" me vendimet që i nxjerrin vetë ata.
Z. Bekim Samadraxha, çështja e parë pajtohem me propozimin e z. Habib Aliut le të njoftohet ministrja, se AKA-ja lëshon vendime me 06.11.2024 për të filluar vitin akademik me 01.10.2024 ku në këtë rastë AKA-ja po merrë vendimet retroaktive, në aspekt ligjor nuk ka të drejtë ta bëjë këtë, çështja e dytë është që dua ta potencoj që kjo është mbledhja e fundit për këtë vit akademik.

Komisioni, i përbërë nga kryetari z. Burim Gashi anëtarët z. Habib Aliu dhe z. Bekim Samadraxha, z.Besim Muharremi, znj.Elhame Shabani, në formë unanime mori vendim që programi "Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis MSc, Kampusi Kryesor Prishtinë" të licencohet për vitin 2025-2026.

Mbledhja përfundoi në ora 10.40

Komisioni per licencimin e BPrAL

- Burim Gashi, kryesues
- Bekim Samadraxha, anëtar
- Habib Aliu, anëtar
- Elhame Shabani, anëtar
- Besim Muharremi, anëtar

*Prishtinë, 21 nëntor 2024*

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVES SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. / Org. Jedinica / Org Unit: 5
Nr. Prot. / Broj Prot. / Prot. No: 3239
Nr. i faqeve / Br. stranica / No. pages: 2
Data / Datum / Date: 04.11.2024

Nr. 12041
13.03.2024 Prishtinë

**Për:** **Komisioni për licencim të IPAL - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Republika e Kosovës**

**Nga:** **Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji – UBT Sh.P.K**

**Lënda: Kërkesë për licencim**

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji - UBT SH. (në tekstin e mëtejm UBT) në bazë te nenit 6 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 25/2021 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë sipas kërkesës të paraqitur nr.5/2688 me datë 13/09/2024 dhe në përputhje me njoftimin nga Agjencia e Kosovës për Akreditim të datës 04.11.2024, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në kërkesën e parë të apostrofuar dhe të inkuadruar edhe programin Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedisi, niveli MSc, kampusi kryesor Prishtinë, paraqet kërkesën plotësuese për licencimin e programit të studimit :

1. **Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis MSc, Kampusi Kryesor Prishtinë- Licencim.**

**Bashkangjitur gjeni njoftimin e pranuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.**

Kolegji UBT ka pranuar njoftimin për akreditimin e programit të theksuar më lartë.
BPrAL Kolegji UBT, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe Udhëzimet Administrative nr. 25/2012 Licencimi i Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, kërkon nga Komisioni për Licencim MASHT që të bëjë licencimin e programit të theksuara më lartë.

Me respekt,

Prof. Dr. Edmond Hajrizi, President i UBT-së

Adresa/ Address: Lagja Kalabria pn; 10000; Prishtinë; Republika e Kosovës
Telefoni/ Phone: 038 541 400; fax. 038 542 138
http://ëëë.ubt-uni.net

Outlook

## Njoftim_AKA

From Arianit M. Krasniqi <Arianit.M.Krasniqi@rks-gov.net>
Date Mon 11/4/2024 9:03 AM
To Artan Tahiri <artan.tahiri@ubt-uni.net>
Cc Elmi Kelmendi <elmi.kelmendi@ubt-uni.net>

Te nderuar,

Ju njoftojme se te premten me 1 nentor ne mbledhjen 130 te KSHC-se eshte shqyrtuar rekomandimi I komisionit te ankesave per korrigjimin e vendimit 1711/24 te dates 20.08.2024.

Me kete rast, KSHC ka miratuar rekomandimin e komisionit te ankesave dhe pas rishqyrtimit te lendes ka vendosur si vijon:

Akreditohet programi i studimit Inxhinieri e Energjise dhe Mjedisit, MSc per periudhe 3 vjecare. Kuota e studenteve per regjistrim eshte 80 studente per vit akademik.

Se shpejti do te ftoheni per t'u pajisur me vendimin ne forme fizike.

Me respekt,
Arianiti

Arianit KRASNIQI
Director of Department for Evaluation and Accreditation
Kosovo Accreditation Agency

Address: Student's Center, 2nd floor
10000 Pristina, Kosovo
Tel: +383 38 200 205 77
Fax: +383 38 213990
Website: https://akreditimi.rks-gov.net/

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Ref.:227024 Date: 06.11.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 130 të mbajtur më datë 01.11.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

## VENDIM

I. Akreditohet programi i studimit i Kolegjit UBT kampusi kryesor në Prishtinë, për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027):

- *Inxhineri e Energjisë dhe Mjedisit MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*

II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.

III. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

IV. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.

V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Kolegji UBT brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

| *Nr.* | *Programi i studimit* | *Bartësit e programit* |
|---|---|---|
| *1.* | *Inxhineri e Energjisë dhe Mjedisit MSc 120 ECTS (A)* | Armend Ymeri<br>Sami Gashi |



AKA | Qendra e Studentëve, kati 2-të, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel. +383 38 212 761 | akreditimi@rks-gov.net | www.akreditimi.rks-gov.net

Affiliate of enqa.

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit AKA ka organizuar vizitat në Kolegjin UBT kampusi kryesor në Prishtinë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit: *Andreas Mehrle, Tauno Otto, Matej Drobnic.*

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

**Për këtë program të studimit;** ***Inxhineri e Energjisë dhe Mjedisit MSc,*** vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 19.06.2024, të cilën kanë konstatuar se nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht dy (2) ndërsa Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.

Fillimisht KShC pas shqyrtimit të raportit të ekspertëve dhe aplikacionit kishte nxjerrë vendim Ref.1711/24 datë 20.08.2024 me të cilin kishte refuzuar akreditimin e këtij programi me gjithë rekomandimin pozitiv nga ekipi i ekspertëve të jashtëm ndërkombëtarë, KShC kishte kërkuar sqarime shtesë për ndryshimet që ishin bërë në programin Inxhineri e Energjisë dhe Mjedisit MSc. Pas pranimit të sqarimeve shtesë nga Kolegji UBT, KShC ka konstatuar se ndryshimet që ishin bërë në Emërtim, kurrikula, lëndë si dhe në tërësinë e programit përfshijnë më tepër se 30 %, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi çdo ndryshim që përfshinë më tepër se 30% të programit konsiderohet Akreditim dhe jo Riakreditim. Bazuar në Paragrafin 3, nënparagrafin 3.6 të Nenit 37 të ligjit për AKA ku thuhet se, citojmë: *"Institucionet e arsimit të lartë obligohen të njoftojnë AKA-në me shkrim për çdo ndryshim të rëndësishëm, përfshirë:... 3.6. ndryshimin e programit të studimit më shumë se tridhjetë përqind (30%)."*

Pas pranimit të vendimi të KShC-së Ref.1711/24 datë 20.08.2024, UBT brenda afatit ligjor ka parashtruare ankesë në Komisionin e Ankesave, i cili pas shqyrtimit të ankesës ka marr vendim që të aprovoj ankesën dhe i ka rekomanduar KShC-së që të korrigjoj vendimin me arsyetimin se Kolegji UBT gjatë plotësimit të aplikacionit kishte lëshuar gabim teknik në rubrikat e aplikimit, ku në vend që të shkruaj "A" *(Akreditim)* kishte shkruar "R" *(Riakreditim).* Pra gabimi ishte teknik dhe nuk kishte ndonjë problem tjetër përmbajtjesor dhe rrjedhimisht nuk do të duhej të kishte ndonjë pengesë për akreditim të këtij programi.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 130-të, të mbajtur më datë 01.11.2024, ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit të ankesave dhe dokumentacionin e Kolegjit UBT, me ç'rast ka konstatuar gjendjen e njëjtë faktike dhe duke u bazuar në të dhëna e cekur më sipër, në bazë të kompetencave ligjore vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- *Kolegjit* UBT *kampusi kryesor në Prishtinë;*
- *MASHTI;*
- *Arkivit të AKA-së.*



AKA | Qendra e Studentëve, kati 2-të, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel. +383 38 212 761 | akreditimi@rks-gov.net | www.akreditimi.rks-gov.net

Affiliate of enqa.

**Burim Gashi**

**From:** Burim Gashi
**Sent:** Thursday, November 21, 2024 9:27 AM
**To:** Elhame Shabani
**Cc:** Habib Aliu; Besim Muharremi; Bekim Samadraxha
**Subject:** FW: ftese per takim
**Attachments:** Kërkesë nr.5 3239 Kolegji UBT.PDF; 2024, 2270 Vendim për Kolegjin UBT.pdf; Mbledhja e Komisionit per licencimin e BPrAL e mbajtur me 18.11.2024.docx

E nderuara znj. Shabani,

Sipas takimit qe kishim te komisionit për Licencimin e Kolegjit UBT, ju kisha lutur nëse mundeni te draftoni vendimin e programi te studimit "Inxhinieri e Energjis dhe Mjedisit- MSC. Po besoj qe e keni ndonjë model/form te vendimeve qe i keni nxjerr.
Po ashtu po ju dërgojë edhe procesverbalin e takimit te pregaditur nga Hatixhe Gashi, sipas takimit te mbajtur me date 18.11.2024. Ta rishikojmë procesverbalin mos kemi diqka për te shtuar.

**From:** Burim Gashi
**Sent:** Thursday, November 14, 2024 1:40 PM
**To:** Habib Aliu <Habib.Aliu@rks-gov.net>; Bekim Samadraxha <Bekim.Samadraxha@rks-gov.net>; Besim Muharremi <Besim.Muharremi@rks-gov.net>; Elhame Shabani <Elhame.Shabani@rks-gov.net>
**Cc:** Fadile Dyla <Fadile.Dyla@rks-gov.net>
**Subject:** RE: ftese per takim

Përshëndetje Anëtarë te Komisionit për licencimin e BPrAL-ve

Me duhet te ju njoftoj qe për shkak agjendës se ngarkuar, do te shtyhet takimi për ri-trajtimin e kërkeses nr. 5 3239 te Kolegjit" UBT'. Takimi do te mbahet te hënën me date 18.11.2024 ne po te njëjtën ore, tek zyra 313.

Me respekt!
Burim Gashi
u.d. i Drejtorit të Departamentit të Arsimit të Lartë, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Republika e Kosovës

Email: burim.gashi@rks-gov.net
Tel: 038/ 200-20-066, ext 211-012
Mob: +383 44-161-803

**From:** Burim Gashi
**Sent:** Thursday, November 14, 2024 9:06 AM
**To:** Habib Aliu <Habib.Aliu@rks-gov.net>; Bekim Samadraxha <Bekim.Samadraxha@rks-gov.net>; Besim Muharremi <Besim.Muharremi@rks-gov.net>; Elhame Shabani <Elhame.Shabani@rks-gov.net>
**Cc:** Fadile Dyla <Fadile.Dyla@rks-gov.net>
**Subject:** FW: ftese per takim

Te nderuar,

Ju ftoje edhe njëherë sot prej orës 13:30 tek zyra nr. 313 ne takim te komisionit për licencim dhe ri-licencim te BPrAL-ve. Qëllimi i takimit është qe te ri-trajtohet edhe njëherë kërkesa nr. 5 3239 te Kolegjit'' UBT', për shkak mungesës se anëtarëve te komisionit. Siç po shihet anëtarja Elhame Shabani është ne pushim vjetor.

Me respekt!
Burim Gashi
u.d. i Drejtorit të Departamentit të Arsimit të Lartë, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Republika e Kosovës

Email: burim.gashi@rks-gov.net
Tel: 038/ 200-20-066, ext 211-012
Mob: +383 44-161-803

**From:** Besim Muharremi
**Sent:** Tuesday, November 12, 2024 3:47 PM
**To:** Burim Gashi <Burim.Gashi@rks-gov.net>; Elhame Shabani <Elhame.Shabani@rks-gov.net>
**Cc:** Fadile Dyla <Fadile.Dyla@rks-gov.net>; Habib Aliu <Habib.Aliu@rks-gov.net>; Bekim Samadraxha <Bekim.Samadraxha@rks-gov.net>
**Subject:** RE: ftese per takim

Përshëndetje,
Mendoj se qasja e këtyre takimeve (pa paragjykuar vendim marrjen), nuk është komfor vendimit te ngritur për vlerësim te kërkesave, ndryshe edhe pse ngritën komisionet?!
Nëse ka qen aq e ngutshme dhe ka qen dashtë te merret vendim urgjent, kujtoj se nuk është përgjegjësi e jona dhe as e institucionit te jetë ne kujdestari te OE për kërkesa te tyre te "VONSHME".
Ka qen dashtë dhe mendoj se duhet qe komisioni tash dhe ne vazhdimësi te pritet për tu kompletuar me pastaj te diskutohet për akorde si Licencimi apo jo.
PS. Këto janë opinione personale dhe nuk mendoj se ndikojnë ne qasjen tuaj, ndryshe unë nuk nënshkruaj dhe as qe aprovoj një dokument u nuk kam qen pjesëmarrës.

**Besim Muharremi**
Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Investimeve dhe Projekteve Arsimore
Departamenti për Zhvillimin e Standardeve dhe Normativave për Hapësirat Arsimore
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Republika e Kosovës

**e-mail: besim.muharremi@rks-gov.net**
tel: 038 211 021, ext 20 035
mob: +383 44 179 339

**From:** Burim Gashi
**Sent:** Tuesday, November 12, 2024 3:36 PM
**To:** Besim Muharremi <Besim.Muharremi@rks-gov.net>; Elhame Shabani <Elhame.Shabani@rks-gov.net>
**Cc:** Fadile Dyla <Fadile.Dyla@rks-gov.net>; Habib Aliu <Habib.Aliu@rks-gov.net>; Bekim Samadraxha <Bekim.Samadraxha@rks-gov.net>; Burim Gashi <Burim.Gashi@rks-gov.net>
**Subject:** RE: ftese per takim

Përshëndetje Besim dhe Elhame

Ne baze takimit te komisionit i mbajtur sot, ku prezent ishim: Burim Gashi, Habib Aliu dhe Bekim Samdraxha dhe ne mungesën tuaj për trajtimin e kërkesës nr. 5 3239 te kolegjit'' UBT' drejtuar komisionit për licencim dhe ri licencim te BPrAL-ve si ne nivel Institucional dhe te programeve te studimit. Ne trajtuam kërkesën dhe vendim qe programi i studimit "Inxhinieri e Energjis dhe Mjedisit- MSC, licencohet për vitin akademik 2025-2026. Andaj, kërkojë mendimin e juaj dhe a pajtoheni me vendimin e marre nga ne.

Me respekt!
Burim Gashi
u.d. i Drejtorit të Departamentit të Arsimit të Lartë, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Republika e Kosovës

Email: burim.gashi@rks-gov.net
Tel: 038/ 200-20-066, ext 211-012
Mob: +383 44-161-803

**From:** Burim Gashi
**Sent:** Monday, November 11, 2024 1:11 PM
**To:** Habib Aliu <Habib.Aliu@rks-gov.net>; Bekim Samadraxha <Bekim.Samadraxha@rks-gov.net>; Besim Muharremi <Besim.Muharremi@rks-gov.net>; Elhame Shabani <Elhame.Shabani@rks-gov.net>
**Cc:** Fadile Dyla <Fadile.Dyla@rks-gov.net>
**Subject:** ftese per takim

Te nderuar, Anëtar te komisionit për licencimin e BPrAL-ve

Po ju ftoje ne takim për trajtimin e kërkesës nr. 5 3239 te kolegjit'' UBT''. Nëse nesër jeni te lire prej orës 14:30 date 12.11.2024, ishim takuar tek zyra 313.

Ne attach. gjeni te bashkangjitur kërkesën e Kolegjit "UBT"

Me respekt!
Burim Gashi
u.d. i Drejtorit të Departamentit të Arsimit të Lartë, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Republika e Kosovës

Email: burim.gashi@rks-gov.net
Tel: 038/ 200-20-066, ext 211-012
Mob: +383 44-161-803

**Burim Gashi**

| | |
|---|---|
| **From:** | Burim Gashi |
| **Sent:** | Wednesday, December 18, 2024 1:34 PM |
| **To:** | Naim m. Gashi |
| **Cc:** | Arbërie Nagavci; Fadile Dyla; Bekim Samadraxha; Habib Aliu; Besim Muharremi; Elhame Shabani; Arrita Gola; Donike Kastrati; Besarta H. Balaj; Xheneta Bajrami; Greta Guci; Burim Gashi; Arianit M. Krasniqi; Shkelzen Gerxhaliu |
| **Subject:** | Kërkesë për informim nga AKA |
| **Attachments:** | 2024, 2270 Vendim për Kolegjin UBT.pdf |

I nderuar z. Gashi, drejtor i AKA-s

Uroj te jesh mire me shëndet.

Ne emër te komisioni për licencim dhe ri-licencim të BPrAL po ju drejtohem me këtë email, ju lutem mundësisht te na jepni një sqarim rreth nxjerrjes se vendimit te programit te studimit "Inxhineri e Energjisë dhe Mjedisit, MSc 120 ECTS" te Kolegjit UBT.
Komision i licencimit te BPrAL ka pranuar kërkesën me nr. 5/3239 te datës 04.11.2024 nga Kolegji UBT për licencimin e këtij programi te nivelit MSc. Kësaj kërkese ju është bashkangjitur edhe njoftimi i datës 04.11.2024 nga AKA, se ne mbledhjen e 130 te KSHC te mbajtur me 1 nëntor është shqyrtuar dhe aprovuar rekomandimi i komisionit te ankesave për korrigjimin e vendimit 1711/24 te datës 20.08.2024.
Me rekomandim te komisionit te ankesave të AKA-s, KSHC, ka aprovuar rekomandimin e Komisionit te Ankesave dhe ka vendosur që të akreditoj programin e studimit "Inxhineri e Energjisë dhe Mjedisit, MSc 120 ECTS" për periudhën tre vjeçare (1 tetor 2024 deri me 30 shtator 2027) me Nr. i vendimit 2270/24 të datës 06.11.2024.

Arsyeja qe po ju drejtohem ne emër te komisionit për licencimin dhe ri-licencimin e BPrAL-e, është se, komision e ka trajtuar kërkesën e Kolegjit UBT për programin ne fjale dhe duke u bazuar ne dispozitat ligjore ka nxjerre vendim me nr. 5/3235 te datës 22.11.2025 ku programi i studimit te nivelit MSc te licencohet prej vitit akademik 2025/2026 e jo prej viti akademik 2024/2025 siç është marr vendimi nga KSHC. Andaj, ky është rasti i parë ku KSHC nxjerr vendim me date 06.11.2024 dhe akrediton program te studimit duke filluar prej datës 1 tetor 2024. Sipas procedurave administrative vendimet nxjerrën para fillimit te vitit akademik, para 1 tetorit.

